



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
SENATI

Nr. 2617 prot.

Shkodër, më 07.09, 2021

V E N D I M

nr. 273, datë 07.09.2021

“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR ANËTARË TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT”

Në mbështetje të nenit 38, pika gj, nenit 48, pika 1 të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Rektorit, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.09.2021

V E N D O S I:

1. Miratimin e kriterëve për anëtarë të Bordit të Administrimit përfaqësues të USH-së:
 - a. Të jetë pedagog me kohë të plotë në USH.
 - b. Të ketë të paktën gradën shkencore “Doktor”.
 - c. Të mos jetë i zgjedhur si autoritet apo në organet drejtuese të USH-së.
 - d. Të mos jetë në ndjekje penale dhe ndaj tij të mos jetë dhënë masë e sigurimit personal; të mos jetë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë, të mos jetë i dënuar më parë për vepra penale si dhe ndaj tij të mos jetë dhënë masë disiplinore.
2. Ngarkohet Rektori për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARË
Prof. dr. Suzana GOLEMI